



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 42

Tiranë – E shtunë, 23 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHMP-së nr. 4271, datë 23.6.2016	Ndaj subjektit fizik/juridik “Natalina Rushaj”, me aktivitet bar klub “Planet”, protokolluar me nr. 3367, datë 23.5.2016..... 3
Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHMP-së nr. 4273, datë 23.6.2016	Ndaj subjektit fizik/juridik “Copri Aktor”, protokolluar me nr. 3009, datë 10.5.2016..... 3
Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHMP-së nr. 4274, datë 23.6.2016	Ndaj subjektit “Copri Aktor”, protokolluar me nr. 3302, datë 19.5.2016.. 4
Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHMP-së nr. 4914, datë 19.7.2016	Ndaj subjektit fizik/juridik “Kristo Hamitaj”, me aktivitet me muzikë “Club Agustino”, me nr. 3688, prot., datë 3.6.2016..... 4
Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHMP-së nr. 7363, datë 4.11.2016	Ndaj subjektit fizik/juridik “Kristo Jovani”, protokolluar me nr. 5508 prot. datë 19.8.2016..... 5
Vendim i Komisionit të Ankimit të ISHMP-së nr. 4067, datë 30.8.2017	Ndaj subjektit fizik/juridik “Xholjon Pejo”, protokolluar me nr. 3609 prot., datë 26.7.2017..... 5
Kërkesë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 2168, datë 22.12.2017	Për shpalljen e vendeve vakante në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.... 6



VENDIM

Nr. 4271, datë 23.6.2016

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 13, datë 15.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj personit fizik “Natalina Rushaj”, me aktivitet bar klub “Planet”, protokolluar me nr. 3367, datë 23.5.2016,

pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material, dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika a, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimit:

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar me nr. 13, datë 15.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë dhe rrëzimin e ankimit të personit fizik “Natalina Rushaj”, me aktivitet bar klub “Planet” ndaj këtij vendimi përfundimtar.

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi të dënimit me gjobë në vlerën 30.000 lekë, dhënë me vendimin përfundimtar me nr. 13, datë 15.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë.

KRYEINSPEKTORI
Ergys Agasi

Ky akt hyn në fuqi menjëherë!

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.

VENDIM

Nr. 4273, datë 23.6.2016

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 4, datë 6.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit “Copri Aktor”, protokolluar me nr. 3009, datë 10.5.2016,

pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë materia, dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146 pika a, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimit:

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar me nr. 4, datë 6.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Copri Aktor” ndaj këtij vendimi përfundimtar.

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi të dënimit me gjobë në vlerën 500.000 lekë, dhënë me vendimin përfundimtar me nr. 4, datë 6.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë.

KRYEINSPEKTORI
Ergys Agasi

Ky akt hyn në fuqi menjëherë!

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



VENDIM

Nr. 4274, datë 23.6.2016

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 5, datë 17.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit “Copri Aktor”, protokolluar me nr. 3302, datë 19.5.2016,

pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika a, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimit:

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar me nr. 5, datë 17.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Copri Aktor” ndaj këtij vendimi përfundimtar.

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi të dënimit me gjobë në vlerën 1.000.000 lekë, dhënë me vendimin përfundimtar me nr. 5, datë 17.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë.

KRYEINSPEKTORI
Ergys Agasi

Ky akt hyn në fuqi menjëherë!

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.

VENDIM

Nr. 4914, datë 19.7.2016

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit të subjektit “Kristo Hamitaj”, me aktivitet me muzikë, “Club Agustino” me nr. 3688, prot., datë 3.6.2016, kundër vendim dënimit me gjobë nr.14, datë 15.5.2016, të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, dega rajonale Tiranë,

pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se vendimi dënimit me gjobë është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material, dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 146, pika a, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, i “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimit:

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimit me gjobë në vlerën 30.000 lekë, nr. 14, datë 15.5.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë dhe mospranimin e ankimit të subjektit “Kristo Hamitaj” ndaj këtij vendimi.

KRYEINSPEKTORI
Ergys Agasi

Ky akt hyn në fuqi menjëherë!

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



VENDIM

Nr. 7363, datë 4.11.2016

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr.6, datë 12.8.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit fizik/juridik “Kristo Jovani”, protokolluar me nr. 5508 prot., datë 19.8.2016,

pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material, dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 137, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimit:

VENDOSI:

Ndryshim të vendimit përfundimtar me nr. 6, datë 12.8.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, dhe lënien në fuqi të ankimit të subjektit “Kristo Jovani” sh.p.k ndaj këtij vendimi përfundimtar.

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi të dënimit me gjobë më vlerën nga 500.000 lekë në 300.000, dhënë me vendimin përfundimtar me nr.4, datë 19.8.2016, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë.

KRYEINSPEKTORI
Ergys Agasi

Ky akt hyn në fuqi menjëherë!

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.

VENDIM

Nr. 4067, datë 30.8.2017

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr.6, datë 18.7.2017, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, ndaj subjektit fizik/juridik “Xholjon Pejo”, protokolluar me nr. 3609 prot., datë 26.7.2017,

pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë, rezultoi se është marrë në përputhje me ligjin procedural dhe atë material, dhe përbën një akt administrativ të vlefshëm dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi në zbatim të nenit 137, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimit:

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit me gjobë në vlerën 300.000 lekë, nr. 6, datë 18.7.2017, të ISHMP-së, dega rajonale Tiranë, rrëzimin e ankimit të subjektit “Xholjon Pejo” ndaj këtij vendimi administrativ.

KRYEINSPEKTORI
Ergys Agasi

Ky akt hyn në fuqi menjëherë!

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

**KËRKESË****Nr. 2168, datë 22.12.2017****PËR SHPALLJEN E VENDEVE VAKANTE
NË KOMISIONIN E PAVARUR TË
KUALIFIKIMIT**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kërkon shpalljen e një vendi vakant më datë 23.12.2017, me tekstin e mëposhtëm:

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall vendin vakant për pozicionin:

Specialist IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijojnë:

a) Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë në Inxhinieri Informatike, Informatikë, Teknologji Informacioni etj.

b) Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e Teknologjisë së Informacionit.

c) Të ketë njohuri të mira në Windows (7/8/10)

d) Të ketë njohuri të mira në administrimin e sistemeve, si: *Active Directory*, *Outlook Mail Client*.

e) Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.

f) Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve *web* (*Worldpress*, *Drupal*, *Joomla* etj.).

g) Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidati duhet të plotësojë kriteret për t'u pajisur me “certifikatë sigurie”, sipas VKM-së nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore,

e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidati duhet të ketë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afatet kohore të limituara.

Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 5.1.2018, në një nga format e dhëna më poshtë:

a) Paraqitja e aplikantit së bashku me dokumentet përkatëse pranë institucionit të KPK-së, në adresën: Rruga e Kavajës, Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e hëna në të premte, ora 09.00 - 16.00.

b) Kërkesë me shkrim dërguar me postë zyrtare në adresën: Rruga e Kavajës, Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 29.12.2017, që vërtetohet me fletëmandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar.

c) Kërkesë për aplikim nëpërmjet postës elektronike në adresën komisionipavarurikualifikimit@gmail.com i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

a) Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

b) Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuar);

c) Dëshmi penaliteti;

d) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

e) Çdo dokument tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**Ramadan Çaço**

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.